



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 nëntor 2016
Nr. ref.: RK998/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI76/16

Parashtrues

Qeveria e Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 41/2016, të 14 marsit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilën sipas autorizimit të Ministrisë së Drejtësisë e përfaqëson Shefqet Hasimi, zyrtar i lartë ligjor i Zyrës së Avokaturës Shtetërore (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 41/2016, të 14 marsit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, për të cilin parashtruesi i kërkesës konsideron se nuk është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cili nen i Kushtetutës është shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 maj 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 13 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 13 shtator 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović kryesues të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Robert Carolan i cili me 9 shtator 2016 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës.
9. Më 16 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 janar 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) me Vendimin nr. 03-55 bëri shpronësimin e patundshmërive që gjenden në ngastrat kadastrale nr. 800, 801 dhe 802 ZK Tërrnje për të ndërtuar autostradën.

11. Me këtë vendim të Qeverisë, lartësia e kompensimit për shpronësimin e këtyre ngastrave ishte përcaktuar në shumën prej 4 € për një metër katror, përkatesisht me shumën totale prej 91.760 € për këto tri ngastra.
12. Më 15 shkurt 2012, pronarët e ngastrave kadastrale të pakënaqur me lartësinë e kompensimit të ofruar nga Qeveria, u ankuan në Gjykatë duke kërkuar që të përcaktohet lartësia e kompensimit të drejtë për shpronësimin e këtyre patundshmërive dhe fitimet e humbura.
13. Më 15 maj 2015, Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, me Aktvendimin CN. nr. 159/13, në bazë të mendimeve të arsyetuara të të dy ekspertëve, e përcaktoi kompensimin si në vijim:

*“Për paluajtshmëritë e shpronësuara ngastrat 800, 801 dhe 802 ZK Tërrnje në shumë 146,320.00
Për fitimin e humbur për janxhë shumën 6.580,00 €.
Në total vlera për kompensim 152.900,00 € (Njëqindë e pesëdhjetë e dymijë e nëntëqind euro)”.*
14. Në mbledhjen e provave, Gjykata Themelore caktoi një ekspert financiar për përcaktimin e vlerës së ngastrave të shpronësuara, ndërsa për përcaktimin e lartësisë së shumës së fitimit të humbur, Gjykata Themelore caktoi një ekspert në lëmin e bujqësisë, sipas propozimit të përfaqësuesit të Qeverisë.
15. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Qeveria parashtroi ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 26 tetor 2015, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin CA. nr. 3578/2015, e refuzoi si të pabazuar “ankesën e përfaqësuesit të autorizuar” të Qeverisë dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
17. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Qeveria parashtroi kërkesë për revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe propozoi që të anulohen të dy aktvendimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
18. Më 14 mars 2016, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. 41/2016, e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk specifikoi se cilat të drejta ose dispozita kushtetuese pretendohet të jenë shkelur.
20. Parashtruesi kërkon nga Gjykata “ta shqyrton fitimin e humbur [...] Të konstatohet baza e kushtetutshmërisë për fitimin e humbur në vlerën e vërtetuar prej 6.580,00 €, ka bazë, apo nuk ka bazë”.

21. Në mbështetje të këtyre kërkesave, parashtruesi bashkëngjit Aktvendimin Rev. nr. 4/2014, të Gjykatës Supreme, të 19 marsit 2014, me të cilin u vendos lidhur me fitimin e humbur dhe shpronësimin e objekteve të tjera që nuk kishin të bëjnë asgjë me këtë rast, dhe me të cilin Gjykata Supreme pjesërisht pranoi revizionin e parashtruesit dhe e zvogëloi lartësinë e fitimit të humbur.
22. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se ekziston një dallim i madh ndërmjet lartësisë së kompensimit prej “6.29 € dhe € 6.42” për metër katror të caktuar nga gjykatat e rregullta në bazë të mendimit të ekspertit dhe lartësisë së kompensimit “4 €” për një metër katror, të përcaktuar me vendimin për shpronësim të Qeverisë.
23. Parashtruesi i kërkesës konsideron se vlerësimi i ekspertit është “i lartë” dhe “një ekspertizë e një eksperti profesionist duhet të jetë me dallim të arsyeshëm. Këtë dallim nga eksperti që gjykata e ka aprovuar nuk ka mbështetje ligjore dhe bazë nga ekspert jo profesionist nga lëmia e bujqësisë”.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
26. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”
27. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
28. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) parashtuesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

29. Gjykata vëren se parashtuesi në thelb kërkon që Gjykata Kushtetuese të lëshohet në vlerësimin e gjendjes faktike dhe “të konstatohet baza e kushtetutshmërisë për fitimin e humbur”, si dhe të vlerësojë kushtetutshmërinë e lartësisë së kompensimit për patundshmëritë e shpronësuara.
30. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës nuk pajtohet me konstatimet e gjykatave të rregullta lidhur me lartësinë e fitimit të humbur dhe lartësinë e kompensimit për patundshmëritë e shpronësuara, por nuk saktëson se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.
31. Parashtuesi i kërkesës në thelb e konteston interpretimin e mënyrës në të cilën gjykatat e rregullta e përcaktuan lartësinë e fitimit të humbur dhe lartësinë e kompensimit për patundshmëritë e shpronësuara. Këtë interpretim e arsyetuan gjykatat e rregullta në tri instanca dhe konkluzioni i tyre u arrit pas shqyrtimit të hollësishtë të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtuesi i kërkesës.
32. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk ka theksuar saktësisht dhe konkretisht cilat të drejta janë shkelur dhe nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese. Ai vetëm kërkon nga Gjykata të “konstatohet baza e kushtetutshmërisë për fitimin e humbur” dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendimi i 31 majit 2005).
33. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në Prizren (Dega e Suharekës), me Aktvendimin CN. nr. 159/13 e përcaktoi kompensimin bazuar në gjetjet e dy ekspertëve të cilët edhe i ka dëgjuar në procedurën ku janë paraqitur provat. Gjykata Themelore dha një shpjegim të detajuar të mënyrës me të cilën e kishte përcaktuar lartësinë e fitimit të humbur dhe lartësinë e kompensimit për patundshmërinë e shpronësuara.
34. Vërtetimi i tillë i gjendjes faktike nga Gjykata Themelore dhe arsyetimi për një gjendje të tillë faktike, është pranuar si i drejtë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
35. Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e parashtuesit të kërkesës se lartësia e kompensimit është “shumë e lartë” dhe e bërë nga “eksperti jo profesionist nga lëmia e bujqësisë”.

36. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk janë të sakta; përkundrazi, Gjykata Themelore pranoi propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të Qeverisë dhe e caktoi një ekspert të lëmit bujqësor dhe në bazë të mendimit të arsyetuar të ekspertit, caktoi lartësinë e fitimit të humbur dhe lartësinë e kompensimit për patundshmëritë e shpronësuara.
37. Parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet argumentet dhe provat që i ka konsideruar të rëndësishme për rastin e tij. Të njëjtën kohë, ai kishte mundësi për t'i kontestuar në mënyrë efektive argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare dhe të kontestojë interpretimin e ligjit në procedurat pranë Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.
38. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar siç duhet dhe se ato janë shqyrtuar si duhet nga gjykatat, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin e kontestuar nga parashtruesi i kërkesës janë paraqitur hollësisht, dhe se, procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësi, ishin të drejta.
39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i përsërit në Gjykatë argumentet e njëjta që i kishte paraqitur edhe në procedurën në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, të cilat në këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kishin dhënë përgjigje të arsyetuar.
41. Gjykata përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *Rastin Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu Rastin nr. KI70/11, parashtrues të kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
42. Edhe pse parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike nga gjykatat e rregullta, ai nuk ka treguar se si vendimet e lartpërmendura kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
43. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Litvanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së i 30 qershorit 2009).
44. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kushtet e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i paraqesë dhe t'i mbështesë pretendimet se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

45. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konkludojë se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Snezhana Botusharova



Alta Rama-Hajrizi